

RELACION

“PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.07.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, është mbështetur në nenet: 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ky projektligj ka për qëllim:

- ❖ të lehtësojë barrën e taksimit të lëndëve të para për prodhimin e artikujve të plastikës. Për këtë qëllim propozohet që taksa mbi lëndët e para primare, të cilat importohen për prodhimin e artikujve të plastikës në vend, të ulet nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg.
- ❖ të rimbursojë taksën jo vetëm për ambalazhet që eksportohen, por edhe për çdo artikull tjetër plastik që eksportohet.
- ❖ të përjashtojë nga pagimi i taksës lëndët e para primare apo materialet që përfshi në kapitullin 39 të plastikës, por që përdoren për në procese teknologjike për prodhimin e mallrave jo plastike.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet e miratuara në paketën fiskale në dhjetor 2019, kanë lehtësuar barrën fiskale të prodhuesve vendas dhe importuesve, nëpërmjet uljes së nivelit të taksës, por edhe zgjerimit të bazës së taksueshme, me qëllim eliminimin e shmangieve nga pagimi i saj..

Ndryshimi i paraqitur së fundi, synon të stimulojë më fort prodhimin vendas duke e ulur më tej nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg, pra -60 % nivelin e taksës, si dhe të përjashtojë nga taksa një sërë lëndësh të para dhe artikuj plastikë, të cilët përdoren: në industrinë e ndërtimit në kuadrin e rritjes së eficiencës së energjisë, në industrinë e mobilerisë dhe të prodhimit të bojrave dhe materialeve të ndërtimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është përgatitur në mbështetje neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 68 të rregullores së Kuvendit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon të bëjë përafrim me acquis e Bashkimit European.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ulja e nivelit të taksës për lëndët e para primare nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg llogaritet të ketë një efekt rreth 200 deri 225 milionë lekë në një vit të plotë financiar, duke marrë parasysh që në vitet e kaluara janë importuar rreth 15 mijë tonë lëndë të para primare që përdoret për prodhimin e mallrave të plastikës.

Nisur nga fakti që hyrja në fuqi e këtij ligji do të shtrijë efektet rreth gjysmës së dytë të vitit 2019, ky efekt përgjysmohet.

DEPUTETI

ILIR BEQAJ

